


KARTELA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË PALUAJTSHME				
TË DHËNA ADMINISTRATIVE				
NR. I SKEDËS	GJM 6 (Nr rendor 60 lista drive)			
EMËRTIMI	KALAJA E JERMËS (ANTIGONE)			
FUSHA	ARKEOLOGJI			
GJINIA	FORTIFIKIM - KALA / KËSHTJELLË			
TIPOLOGJIA	QYTET ANTIK			
KODI I ARKIVIT	429 (arkiva IKTK)			
ADRESA	Fshati Saraqinisht			
VENDNDODHJA	QARK	BASHKIA	NJ. DAMINISTRATIVE	FSHATI
	Gjirokaster	Gjirokaster	Antigone	Saraqinisht
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)	Kategori e I			
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES	1. Nr. 6/ dt. 15.01.1963 2. Nr.1886/ dt.10.06.1973			
INSTITUCIONI I SHPALLJES	1.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës 2.Ministria e Arsimit dhe Kulturës			
DATIMI (VITI / SHEK)	Perjudha Helenistike (shek. III p.Kr.); Antikiteti i vonë; Mesjeta			
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK	GJIROKASTER			
PËRDORIMI FILLESTAR	Qytet			
PËRDORIMI I TANISHËM	PARK ARKEOLOGJIK, ATRAKSION TURISTIK			
A KA RRETHIM OBJEKTIT? / GJENDJA E TIJ	JO			
ZONA E MBROJTUR	ZONA MBROJTËSE ËSHTË SHPALLUR NGA REKTORATI I UNIVERSITETIT SHETËROR TË TIRANËS ME VENDIM NR. 6/ DT. 15.01.1963			
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT	40° 5.240'N- 20° 13.352'E			
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR	----			
PRONËSIA	SHTETËRORE			
EMRI I PRONARIT (-VE)	SHTETËRORE			
NR. I PRONËSISE	----			
ZONA KADASTRALE	-----			
SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT	SIPËRFAQJA BRËNDA MUREVE RRETHUER TË QYTETIT ËSHTË 45 HA			


SIPERFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT	-----			
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR	60 HA- NJË TERRITOR ME RREZE 5M DUKE U NISUR NGA MURI FORTIFIKUES			
A KA RRUGË AUTOMOBILISTIKE DERI NË MONUMENT? / GJENDJA E SAJ	PO, ËSHTË E ASFALTUAR DHE NË GJËNDJE SHUMË TË MIRË.			
TË DHENA TEKNIKE				
PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK	<p>Qyteti antik i Antigonesë shtrihet në kodrën e Jermës në jug-perëndim të fshatit Saraqinisht, rreth 15 km nga Gjirokastra. Në pjesën veriore ndodhet kodra e akropolit (686 m m.n.d.) e cila lidhet me një ngushticë me pjesën tjetrën të kodrës ku shtrihet qyteti (642,5 m m.n.d.). Qyteti është themeluar nga Pirro I Epirit në nder të gruas së tij Antigonesë në fillim të shekullit të shek. III para Kr. dhe mendohet të jetë djegur nga gjenerali romak Emilio Paolo në vitin 168 para Kr.. Muri fortifikues i gjatë rreth 4000 m mbyll një sipërfaqe rreth 45 ha. Trashësia e murit arrin rreth 3,5 m dhe pika më e lartë e konservuar arrin lartësinë 3m. Gjatë gjurmëve arkeologjike të viteve 60'-80' janë zbuluar shumë ndërtesa të qytetit si mëposht. Shtëpi banimi të katër tipologjive a) shtëpi me oborr <i>peristil</i> kuadrat, përreth të cilit ndodhem ambiente të ndryshme b) shtëpi me oborr dhe portik nga një ane ose dy (tipi <i>pastas</i> grek) c) shtëpi me korridor të ngushtë të gjatë d) shtëpi me oborr në kënd të shtëpisë. Një nga karakteristikat dalluese të Antigonesë është sistemi I saj urbanistik shumë i rregullt me rrugët ortogonale dhe <i>insule</i> të rrethullta. Një tjetër monument me dimensione të mëdha është shëtitorja <i>stoà</i> e gjatë 60 m që ndodhet në zonën e <i>agora</i>-së. Pas djegies (shenja të karbonit evidente në të gjithë gjurmët e Dh. Budinës) së qytetit ka një fazë çezure të qytetit duke pritur shekullin e IV-V pas Kr. Ndërtimin e një bazilike paleokristiane e tipit trikonkë. Gjatë shek. IX-X pas Kr. ndërtohet një kishë njënefshe me orientim lindje-perëndim në kryqëzimin kryesor të qytetit.</p>			
PËRSHKRIMI KONSTRUKTIV	<p>Teknika e ndërtimit të murit rrethues është <i>emplecton</i>, me dy faqe muri të lidhura me njëra tjetrën nëpërmjet disa mureve transversal dhe hapsira mes tyre është e mbushur me dhë e gurë. Ajo që e bën të veçantë Antigonenë nga të gjithë qytetet e Kaonisë është përdorimi i gjërë i teknikes kuadratike izodomike. Të gjitha strukturat janë të ndërtuar me gurë të medhenj kuadratik dhe në disa raste pa lidhje llaçi, pra në të thatë duke bërë përjashtim muret e brëndshme të shtëpive të cilat janë të ndërtuara me gurë me dimensione të ndryshme dhe të lidhura më baltë.</p>			
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE NË VITE, SHKALLËT E NDERHYRJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga nderhyrja me e lehtë tek me thellë)	VITI 1975-1976	VITI 1978	VITI 1985	VITI 1986-1991
	Punime konservuese në banesat antike (Sektori C, banesa nr. 5, 6)	Konsolidimi i një kanali Sek. D; Konsolidime të mureve Sek. C	Ndërhyrje konsoliduese përgjatë murit rrethues, hyrjes jugore të qytetit dhe muret perimetrale të banesave në Sek. B	Konsolidim i mureve të banesave në Sek. A, B, C, D, E; hyrja jugore dhe fortifikimi

GJENDJA E KONSERVIMIT <i>SHKALLËT E GJENDJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga problematika me e lehtë tek me rëndë)</i>	ÇATIA / MBULESA	DYER / DRITARE	TAVANI/ NDERKATI	STRUKTURA E DRURIT NE AMBIENTET E BRENSHEM (MAFILI, KOLONA, etj
	AFRESKU	IKONOSTASI	MINARJA / KEMBANARJA	DYSHEMEJA/MOZ AIK
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE QË PROPOZOHEN	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërhyrje konsoliduese në të gjitha strukturat e murit që ndodhen në terriorin e Parkut 2. Anastilozë i gjithë murit fortifikues të qytetit, hyrjes jugore dhe kullave si dhe murit rrethues të akropolit 3. Rilevim i detajuar me GPS, Teodolit e gjithë teknikat moderne të nevojshme për këtë procedim i cili është i domosdoshëm për tutelimin dhe manaxhimin e Parkut 4. Rishikim për kufijt e zonës mbrojtëse të qytetit 5. Ndryshimi i emrit të monumentit në listën zyrtare që posedon IMK (të ndryshohet nga “Kalaja e Jermës” në “Qyteti antik i Antigonesë”) 			
DOKUMENTACIONI GRAFIK DHE HARTOGRAFIK				

1. Planimetri e përgjithshme e qytetit



2. Planimetria e bazilikës paleokristiane



DOKUMENTACIONI FOTOGRAFIK



1. Porta hyrëse jugore e qytetit



2. Shtëpia me peristil



3. Pjesë nga stoa jashtë fortifikimit të qytetit



4. Fotografi ajërore relizuar me Drone

BIBLIOGRAFIA:

- R. Perna: "**La valle del Drino in età ellenistica**", në HADRIANOPOLIS II, Risultati delle indagini archeologiche 2005-2010, Bari 2012;
- J. Bogdana, E.Giorgi: "**La carta archeologica del territorio di Phoinike**", në "Il territorio di Phoinike in Caonia. Archeologia del paesaggio in albania meridionale", AnteQuem 2012;
- Dh. Budina: "**Harta arkeologjike e lugines se Drinos**", Iliria 1974, 3;
- Raporte të ndryshme nga revista Iliria, 196, 1987, 1989, 1990;
- DH. Budina, "**Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në qytetin Ilir të Jermës**" Materiale të sesionit Arkeologjik, Tiranë, 1968, fq.40-49;
- Dh. Budina "**Kumtim mbi gërmimet arkeologjike në qytetin e Antigonesë (Gjirokastër)**", Buletini arkeologjik, Tiranë 1969, fq. 57-69;
- Dh. Budina, "**Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në vitin 1973 në Antigone**", Iliria, Tiranë 1974,3, fq. 450-454;
- Dh. Budina- Vasil Bereti, "**Gjurmime të mëtejshme të sistemit fortifikues të Antigonesë**", "Monumentet", Tiranë, 1974,7-8, fq. 217-228;
- Dh. Budina, "**Bazilika e Antigonesë(gërmime të vitit 1974)**", Buletini arkeologjik, Tiranë, 1975,5,fq. 117-123;
- Dh. Budina, "**Qyteti Ilir i Antigonesë**" Monumentete e kulturës në Shqipëri, Tiranë, 1975,2, fq. 23-25;
- Dh. Budina, "**Gërmime arkeologjike në vitin 1986- Antigone**" Iliria,Tiranë, 1986,2, fq. 259-261;
- Dh. Budina, "**Gërmime arkeologjike në vitin 1987- Antigone**" Iliria,Tiranë, 1987,2, fq. 248;
- Dh. Budina, "**Gërmime arkeologjike në vitin 1989- Antigone**" Iliria,Tiranë, 1989,2, fq. 276-277;
- Dh. Budina, "**Antigone. Gërmime arkeologjike në vitin 1990**" Iliria,Tiranë, 1990,2, fq. 262-263.

KARTELA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË PALUAJTSHME

TË DHËNA ADMINISTRATIVE


NR. I SKEDËS	88			
EMËRTIMI	RRËNOJAT E MANASTIRIT TË 40 SHENJTORËVE			
FUSHA	ARKITEKTURË			
GJINIA	OBJEKT KULTI			
TIPOLOGJIA	MANASTIR			
KODI I ARKIVIT	-			
ADRESA	NËKODRËN E FSHATIT GJASHTË			
VENDNDODHJA	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	FSHATI
	SARAN DË	SARANDË		GJASHTË
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)	KATEGORIA E I			
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES	1.Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kulturës /nr. 68/7/ dt.30.05.1970 2.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973			
INSTITUCIONI I SHPALLJES	MINISTRIA E ARSIMIT DHE KULTURËS			
DATIMI (VITI / SHEK)	Shek. VI			
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK	SEKTORI I KULTURËS KOMBËTARE SARANDË/ D.R.K.K.VLORË			
PËRDORIMI FILLESTAR	OBJEKT KULTI			
PËRDORIMI I TANISHËM	MONUMENT KULTURE			
A KA RRETHIM OBJEKTI? / GJENDJA E TIJ	PO I MIRË			
ZONA E MBROJTUR	PO VEDNIMI NR. 428 Dt. 20. 06. 2012			
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT	39° 52'20"N , 20° 01'18 "E			
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR	SIPAS TABELES SË AGJENCISË SË SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK			
PRONËSIA				
EMRI I PRONARIT (-VE)				
NR. I PRONËSISE				
ZONA KADASTRALE	8641			
SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT	1910m2 /Rrënoja1-5m			
SIPERFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT	5390m2, rrethim i papërfunduar.			
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR				
A KA RRUGË AUTOMOBILISTIKE DERI NË MONUMENT? / GJENDJA E SAJ	PO / ME ÇAKULL			

TË DHENA TEKNIKE				
PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK	<p>Manastiri i 40 Shenjtorëve ndodhet në lindje të qytetit të Sarandës në majë të kodrës së Gjashtës në pjesën më dominuese të saj. Manastiri i përket periudhës Antikiteti i Vonë shek.VI. Dimensionet e tij janë 40 m gjatësi x 24 m gjerësi.</p> <p>Manastiri është ndërtuar dhe rindërtuar gjatë qindra vjetëve. Në katin mbitokësor përbëhet nga salla e madhe, kisha me shtatë apsida dhe dy narтекse, tre dyer të mëdha dhe dy rreshta dritaresh ishin ndërtuar në fasadë. Në katin e nëndheshëm ose kriptomiku ruhen galeritë (qelat), galeritë me qemer, qemerët e dyfishtë, afreske të periudhës Bizantine, çisterna uji dhe varre.</p> <p>Sot, ruhet në gjendje disi të mirë kati i nëndheshëm kurse kati mbi tokë është dëmtuar rëndë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga bombardimi i avionëve anglezë. Ka nevojë për ndërhyrje konsoliduese - restauruese.</p>			
	<p>Bazilika brënda ka një plan unik , është një shtatëkonkësh, nga tre kolona në çdo nef dhe një apsidë të dalënë fasadën lindore.</p> <p>Konstruksioni me këtë planimetri do të ketë pasur një çati madhështore me qemerë të kryqëzuar , të mbështetur në gjysmëkupolat e shtatë apsidave. Dy narтекse ose oborre janë në anën perëndimore dhe jugore të ndërtesës. Këto ishin të dy korridore arkada me llozha në fondin e secilit duke ofruar panoramën e gjirit të Sarandës dhe ngushticës së Korfuzit.</p> <p>Përdorimi i harkut të dyfishtë është realizuar me gurë të punuar njëllor si të ishin tulla. Apsida lindore ndricohet nga tre dritare madhështore dhe më tej në të njëjtin nivel të ulët gjendej një tjetër ditare për secilin mur anësor, lindor. Këta mure lindorë ndërtpriteshin në katin përdhe nga hapje të harkuara të cilat mundt ë ishin ose dy dyer ose 1 derë dhe 1 nishe.</p> <p>Në hyrjen për në ambjentin e nëndheshëm gjatësor të mbuluar me qemer unik , nën qemerin e madh të jashtëm janë inkorporuar dy qemerë katakombalë të mbivendosura njëri mbi tjetrin në dy kate, ku i poshtmi shërben për të hyrë në bazilikën e nëndheshme.</p> <p>Në pjesën e kapelave të nëndheshmë ruhn një sërë mbetjesh të pikturave murale duke filluar që nga krqyi, palma, pemë te ndryshme, figura shenjtorësh dhe murgjish etj.</p>			
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE NË VITE, SHKALLËT E NDERHYRJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga nderhyrja me e lehtë tek me thellë)	VITI 2001	VITI/ 2003	VITI/2006	VITI/2008 VITI 2017
	2	3	3	3 3
GJENDJA E KONSERVIMIT SHKALLËT E GJENDJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga problematika me e lehtë tek me rëndë)	ÇATIA / MBULESA	DYER / DRITARE	TAVANI/ NDERKATI	STRUKTURA E DRURIT NE AMBIENTET E BRENSHEM (MAFILI, KOLONA, etj
	1	---	4	---
	AFRESKU	IKONOSTASI	MINARJA /KEMBANARJA	DYSHEMEJA/MOZAIK
	5	----	----	3



**NDËRHYRJET KONSERVUESE /
RESTAURUESE
QË PROPOZOHEN**

Konsolidimi i gjithë rrënojave të Kishës dhe Manastirit.
Eliminimi i lagështisë në ambjentet nëntokësore .
Ndërtimi i linjës elektrike dhe ndriçimi i ketyre ambjenteve.
Restaurimi i afreskeve të cilat po shkatërohen nga lagështia.
Devijimi i rrugës automobilistike që sot kalon brënda rrethimit.
Përfundimi i rrethimit në anën perëndimore të monumentit.
Prishja e ndërtesës së ish repartit ushtarak.

DOKUMENTACIONI GRAFIK DHE HARTOGRAFIK



RRETHI I SARANDËS



Zona Arkeologjike "A" dhe "B" e Manastirit te 40 Shenjtorëve

MIRATOHET:
KRYEMINISTRI
Prof. Dr. Sali BERISHA

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES,
RINISE DHE SPORTEVE
MINISTER
Aldo BUNCI

INSTITUTI I MONUMENTEVE TE
KULTURES "DAN STRAZHERRI"
DREJTORI
Prof. Dr. Apollon BAÇE

AGJENCIA E SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK
DREJTORI
Roland OLLI

Zona Arkeologjike "A"
Zona Arkeologjike "B"


Vendimi n. 428, Datë 20.06.2012

ZONAT ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B" E MANASTIRIT TË 40 SHËNJTORËVE




ORTOFOTO MBETJET E MANASTIRIT TE 40 SHENJTOREVE, SARANDE

PLANIMETRIA




PLANIMETRIA E KISHES


Forma e nderteses se vonet e stilit bazilikal



- A - Portikoja dhe Hyrje kryesore per ne Kishe
- B - Holli Qendror i Bazilikes
- C - Hapesira anesore gjysem harkore te ndricuara prej dritaresh
- D - Apsida
- E - Rrenoja te kules se vrojtimit



Ambjentet nentokesore te bazilikes
se Dyzet Shenjtoreve



Rikonstruksioni hipotetik i Kishës

DOKUMENTACIONI FOTOGRAFIK



Rrënojat e Manastirit të 40 Shenjtorëve në vitin 1929,
Foto nga Ugolini



Foto ajrore 1929 - Air photo 1929



3. Pamje balllore e rrënojave të
Manastirit



4. Faqa veriore e murit të
Manastirit



5, 6 Gjurmë të pikturës murale që ruhen në
galeritë e nëndheshme





7. Ambientet (cisterna) në pjesën e nëndheshme



8. Ambient në pjesën e nëndheshme të rrënojave të Manastirit



9, 10 Pamje e jashtme e konstruksionit metalik për mbrojtjen e rrënojave.
Dhjetor 2017



11. Pamje e brendshme e konstruksionit metalik



12. Konstruksioni metalik dhe pamja e një pjese të rrënojave të manastirit, Mars 2018.

BIBLIOGRAFIA:

Will Bowden – John Mitchell “The Church of the forty martires” Minerva 2001

L.M.Ugolini : “La terza & polo”, Bari

N. Ceka : “Ilirët ” 2001

Shaban Sinani : 2000 vjet Art dhe kulturë Kishtare në Shqipëri

I.M.K “Gani Strazimiri” : Ndërhyrje restauruese në Manastirin e 40 Shënjtoreve, Sarande 2012

John Mitchell : “Arkeologjia e pelegrinazhit gjatë antikitetit të vonë në Shqipëri. Bazilika e Dyzet Shenjtorëve”, Monumentet 2004, fq. 5

Ioannis Vitaliotis: “Sarandë- Bazilika e Dyzet Shenjtorëve, Raport paraprak për afresket- pikturat paleokristiane”, Monumentet 2007, fq 69

KOMISIONI I HARTIMIT TË KARTELËS

Leonard Hysi _____

Evjeni Mato _____


Genci Kaci _____

MARS 2018


KARTELA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË PALUAJTSHME				
TË DHËNA ADMINISTRATIVE				
NR. I SKEDËS	40			
EMËRTIMI	QYTETI ILIR I AMANTIES			
FUSHA	ARKEOLOGJI			
GJINIA	VENDBANIM ANTIK			
TIPOLOGJIA	QYTET ANTIK/PARK ARKEOLOGJIK KOMBËTAR			
KODI I ARKIVIT	-			
ADRESA	PLOÇË - VLORË			
VENDNDODHJA	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	FSHATI
	VLORË	-	SEVASTER	PLOÇË
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)	KATEGORIA I			
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES	1. Instituti i Shkencave/ nr. 95/ dt.16.10.1948 2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973			
INSTITUCIONI I SHPALLJES	KËSHILLI I MINISTRAVE, Nr. 396, Dt 31.03.2005			
DATIMI (VITI / SHEK)	SHEK.V-IV p. Kr.			
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK	DRKK VLORË			
PËRDORIMI FILLESTAR	VENDBANIM I FORTIFIKUAR			
PËRDORIMI I TANISHËM	PARK ARKEOLOGJIK KOMBËTAR			
A KA RRETHIM OBJEKTI? / GJENDJA E TIJ	Jo			
ZONA E MBROJTUR	Po			
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT	N- 40°22'44.35'' E- 19°41'54.27''			
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR	19 41'32.7" E 40 22'00. 6" N; 19 41'11. 9" E 40 22'39. 8" N; 19 40'56. 8" E 40 22'52. 1" N; 19 41'25" E 40 22'56. 7" N; 19 42'04.6" E 40 23'08.2" N; 19 42'36.2" E 40 23'08.3" N; 19 42'34.1" E 40 22'59.8" N; 10 42'32" E 40 22'53. 3" N; 19 42'34.6" E 40 22'52.7" N; 19 42'41.2" E 40 22'52.2" N; 19 42'45" E 40 22'48" N; 19 42'28.9" E 40 22'41.9" N; 19 42'18.7" E 40 22'32.3" N; 19 41'53" E 40 22'18.8" N; 19 41'41.5" E 40 22'07.7" N			
PRONËSIA	Pronë shtetërore			
EMRI I PRONARIT (-VE)	-			
NR. I PRONËSISE	-			
ZONA KADASTRALE	-			

SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT	20 ha/613 m mbi nivelin e detit.			
SIPËRFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT	-			
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR	-			
A KA RRUGË AUTOMOBILISTIKE DERI NË MONUMENT? / GJENDJA E SAJ	Po			
TË DHENA TEKNIKE				
PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK	<p>Qyteti antik i Amantia ndodhet në lidje të qyteti të Vlorës në fshatin Plocë, 34 km larg nga qyteti. Stratigrafia e gërmimit dhe monumentet e gjetura dëshmojnë se qyteti ka ekzistuar përrreth 1000 vjet.</p> <p>Amantia përmendet për herë të parë nga Pseudo Skylaksi në mesin e shek. IV p.Kr.Te Stefan Bizanti Amantia bën pjesë tek qytetet epirote. Ajo përmendet në burimet epigrafike në mesin e shek. III p. Kr, në listën e teorëve të Delfit, si një qytet pjesmarës në lojrat delfike. Ajo në mesin e shek. III p. Kr, pret monedhës e saj me legjendën AMANTON. Fortifikimi rrethon pjesën e akropolit, i cili zë një sipërfaqe rreth 19 ha. Jashtë fortifikimit janë vendosur një sërë godina me karakter publik si Stadiumi Antik i shek. III p.Kr, Tempulli Helenistik i njohur si “Tempulli i Afërditës”, Bazilika Paleokristjane, si dhe një sërë strukturash, ndoshta banesa të vendosura në tarracime. E veçanta e këtij qyteti është nekropoli me një numër shumë të madh varresh monumentale, i cili shtrihet në fushat kodrat e pllajtat që rrethojnë kodrën ku ndodhet qyteti. Varret helenistike janë kryesisht ata të tipit “Maqedon”, por kohët e fundit janë zbuluar dhe tipe të tjerë si në rastin e varrit 107, i tipit “Tumë e Ndërtuar”.</p> <p>Në fortifikim numërohen rreth 6 hyrje, pjesa më e madhe e të cilave ndodhen në pjesën qendrore. Më e ruajtuara prej tyre është ajo nr. 6 me hark.</p>			
PËRSHKRIMI KONSTRUKTIV	Teknika e ndërtimit të murreve rrethues është e tipit poligonal dhe izodomik me blloqe kuadratik. Në varre dhe hyrje janë përdorur gjerësisht qemerët.			
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE NË VITE,	VITI	VITI	VITI	VITI
<i>SHKALLËT E NDERHYRJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga nderhyrja me e lehtë tek me thellë)</i>	1990	-	-	-
GJENDJA E KONSERVIMIT	ÇATIA / MBULESA	DYER / DRITARE	TAVANI/ NDERKATI	STRUKTURA E DRURIT NE AMBIENTET E BRENDSEHEM (MAFILI, KOLONA, etj


SHKALLËT E GJENDJES <i>/1/2/3/4/5/</i> <i>(nga problematika me e lehtë tek me</i> <i>rendë)</i>	-	-	-	-
	AFRESK U	IKONOSTA SI	MINARJA /KEMBAN ARJA	DYSHEMEJA/MO ZAIK
	-	-	-	-
NDËRHRYJET KONSERVUESE / RESTAURUESE QË PROPOZOHEN	<ul style="list-style-type: none"> • Pastrim vegjetacioni • Restaurim i murit anësor të portës me hark. • Restaurim i varrit 107. • Restaurim i Stadiumit Antik. 			
DOKUMENTACIONI GRAFIK DHE HARTOGRAFIK				



1 Rrethi Vlorë. 2 Ortofoto




3 Zona e Mbrojtur.




Planimetria e qytetit antik Amantia: 1. Agoraja; 2. porta nr. 1; 3. porta nr. 6; 4. Stadiumi; 5. Tempulli i Afërditës


4 Planimetri




5 Planimetri e Stadiumit



6 Planimetri e Bazilikës.



7. Hyrja nr.6.



8 Rikonstrukcion i varrit 107.

DOKUMENTACIONI FOTOGRAFIK



1 Kodra ku ndodhet qyteti antik.



2 Stadiumi Antik.



3 Hyrja nr. 6




4 Mur Poligonal.



5 Mur Izodomik.



6 Tempulli i Afërditës.



7 Bazilika Paleokristiane.



8 Varri 107.

BIBLIOGRAFIA:

- S. Anamali., Vjosa dhe qëndra e saj antike në luginën e saj, Buletin i Institutit të Shkencave, Nr 4. 1948.
- S. Anamali., Amantia, Iliria Nr 2, 1972, F. 61-133.
- C.Patch., "Das sandschak Berat in Albanien", Wien, 1904, f. 23-58.
- N. Ceka., Qendrat e fortifikuara të amantëve, Monumentet 10, 1975, f. 22-31.
- L. M. Ugolini., Albania Antica, I, Roma 1927, f. 115-116.
- J. Buzo., Qyteti antik Amantia, Candavia 6, 2016, f. 21-31.
- E. Hobdari, J. Buzo., Raporti i punës arkeologjike në Amantia (2015), Candavia 6, 2016, f. 131-143.
- J. Buzo, E. Hobdari., Nekropoli i Amantias: Varre dhe shpërndarja e tyre gjatë shek. IV-I p. Kr, Candavia 4, 2014, f. 19-74.
- P. Cabane, M. Korkuti, A. Baçe, N. Ceka., Harta Arkeologjike e Shqipërisë, Tiranë 2008.

Përgatiti :

Dt. 30.03.2018


Kriledjan Çipa

KARTELA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË PALUAJTSHME				
TË DHËNA ADMINISTRATIVE				
NR. I SKEDËS	2			
EMËRTIMI	KALAJA E PORTO-PALERMOS			
FUSHA	ARKITEKTURË			
GJINIA	FORTIFIKIME/KALA			
TIPOLOGJIA	KALA MESJETARE			
KODI I ARKIVIT	32428			
ADRESA				
VENDNDODHJA	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	FSHATI
	VLORË	HIMARË		
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)	KATEGORIA 1			
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES	NR. 586, DT, 17.03.1948/NR. 4874, DT, 23.09.1971			
INSTITUCIONI I SHPALLJES	Aprov..Ligj. Nr. 609, DT, 24.05.1948			
DATIMI (VITI / SHEK)	VITI 1814/SHEK XIX			
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK	DRKK VLORË			
PËRDORIMI FILLESTAR	KALA			
PËRDORIMI I TANISHËM	KALA E VIZITUESHME			
A KA RRETHIM OBJEKTI? / GJENDJA E TIJ	JO			
ZONA E MBROJTUR	VENDIM Nr. 7, DT, 10. 03. 2014			
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT	N 40° 3'44 . 2188" E 19° 47'27. 2868			
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR	<p>1. N 40°3'50.46" E 19°47'34.29" 2. N 40°35'1.58" E 19°47'37.51" 3. N 40°3'48.52" E 19°47'39.10" 4. N 40°34'6. 45" E 19°47'40.52" 5. N 40°3'44.20" E 19°47'41.19" 6. N 40°3'42.07" E 19°47'44.53" 7. N 40°3'40.43" E 19°47'47.39" 8. N 40°3'39.29" E 19°47'46.59" 9. N 40°3'37,71" E 19°47'43.79" 10. N 40°3'36.14" E 19°47'33.37" 11. N 40°3'36.89" E 19°47'26.17" 12. N 40°33'9.77" E 19°47'20.91" 13. N 40°3'43.41" E 19°47'17.56" 14. N 40°3'49.50" E 19°47'17.56" 15. N 40°3'50.77" E 19°47'26.68"</p>			
PRONËSIA	SHTETËRORE			
EMRI I PRONARIT (-VE)				
NR. I PRONËSISE				


ZONA KADASTRALE	NR. 3095
SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT	691 m ² /8 m
SIPERFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT	
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR	72168.24 m ²
A KA RRUGË AUTOMOBILISTIKE DERI NË MONUMENT? / GJENDJA E SAJ	PO /E KEQE
TË DHENA TEKNIKE	
PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK	<p>Pas nënshtimit të bregdetit Jon, nga Butrinti deri në Vlorë, Ali Pasha u kujdes të ndërtonte edhe në këtë zonë disa kështjella. Por Aliu ndërtoi një kështjellë solide në Porto-Palermo, e cila ruhet në gjendje të mirë edhe sot. E ngritur mbi një rrip toke, që futet thellë në det, ajo ka një formë trekëndëshe me tre bastione të mprehta në qoshet dhe një oborr që hapet nga ana perëndimore ndërmjet dy bastjoneve. Por ndryshe nga kështjellat e përshkruara deri tani, ajo e Porto-Palermos është krejtësisht e mbuluar dhe mbi parapetin që rrethon tarracën janë hapur shumë frëngji për topa. Në brendësi ka salla, depo dhe kthina të shumta. Një palë shkallë guri, të ndërtuara në pjesën qendrore, të ngjisin, në tarracë nëpërmjet një të hapure katërkëndëshe, të lënë aty për këtë qëllim. Të gjitha kthinat mbulohej me qemere guri. Një kujdes i veçantë është treguar për mbrojtjen e hyrjes, që ndodhet në mesin e njërit ballë, midis dy bastionesh. Nga brenda, ajo kontrollohet prej murit me frëngji pushkë të një kthine anësore; gjithashtu një mur me frëngji është ndërtuar në anën e brendshme, përballë hyrjes. Në bastjone dhe në këndet e oborrit, në krahun perëndimor gjenden rreth 5 vende vrojtimi për rojet. Ali pasha ndërtoi Kalanë e Porto-Palermos, në të cilin u vendos një garnizon ushtarak, siç e dëshmojnë udhëtarët e huaj të fillimit të shek. XIX, të cilët e vizituan këtë kala në vitet 1799 dhe 1804, konsulli Francez Pouqueville dhe koloneli anglez Ëilliam Martin Leake. Përshkrimet më të detajuara rreth kalasë dhe gjirit në fjalë i gjejmë pikërisht tek konsulli Francez. Pukëvili i cili e prek për herë të parë tokën shqiptare në Porto-Palermo shkruan se: "Gjiu ose porti i Palermos ka një dalje rreth çerek milje midis pikave shkëmbore, ku deti përplasat furishëm. Kështjella ndodhet në pikën jugore të hyrjes dhe lidhet me kontinentin me një rryp të ulët dhe të ngushtë. Ajo përbëhet nga një shesh me disa pozicione të fortifikuara, me ca topa, në afërsi ka ca magazina, një shtëpi që shërben si doganë dhe një kishë.</p>

<p align="center">PËRSHKRIMI KONSTRUKTIV</p>	<p>Për sa i përket trajtimit të jashtëm, kalaja shquhet për veshjen me gurë të latuar, për trajtimin monumental të hyrjeve si dhe për kornizat horizontale prej guri të thjeshtë. Trashësia e mureve arin në 4 m. Ajo ka forma të rregullta gjeometrike të planimetrive, lartësia e barabartë e kullave dhe kurtinave dhe rënia e tyre me pjerrësi në anën e jashtme, duke filluar që nga pjesa e sipërme e tyre; mbisundimi i formave poligonale të kullave dhe krijimi i parapetit me frëngji. Kalaja e mbuluar e përballon peshën e taracës, duke ndëruar ambjente të brendshme të mbuluar me qemer cilindrik.</p>			
<p>NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE NË VITE,</p> <p><i>SHKALLËT E NDERHYRJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga nderhyrja me e lehtë tek me thellë)</i></p>	<p>VITI/2004</p>	<p>VITI/2006</p>	<p>VITI/2008</p>	<p>VITI</p>
<p>GJENDJA E KONSERVIMIT</p> <p><i>SHKALLËT E GJENDJES / 1 / 2 / 3 / 4 / 5 / (nga problematika me e lehtë tek me rendë)</i></p>	<p>ÇATIA / MBULESA</p>	<p>DYER / DRITARE</p>	<p>TAVANI / NDERKATI</p>	<p>STRUKTURA E DRURIT NE AMBIENTET E BRENDSEME (MAFILI, KOLONA, etj)</p>
			<p align="center">3</p>	
	<p>AFRESKU</p>	<p>IKONOSTASI</p>	<p>MINARJA / KEMBANARJA</p>	<p>DYSEMEJA/MOZAIK</p>
				<p align="center">2</p>
<p>NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE QË PROPOZOHEN</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Restaurim i taracës 2. Restaurim i dyshemesë së oborrit 3. Ndërhyrje konservuese në mure dhe mbushje të fugave 4. Shtrimi me kalldrëm i rrugës që të çon tek kalaja 5. Vendosja e energjisë elektrike për ndriçimin e ambjenteve. 			
<p>DOKUMENTACIONI GRAFIK DHE HARTOGRAFIK</p>				

Ortofoto



Planimetri



ZONA MBROJTËSE E KËSHTJELLES SË PORTO PALERMOS, VLORË



LEGJENDA: ■ Këshitjella ■ Kisha e Shën Kollit ■ Perimetri i Zonës së mbrojtur

Koordinatat e sipërfaqes së zonifikimit:

1. 40° 3'50.46"N 19°47'34.29"E	5. 40° 3'44.20"N 19°47'41.19"E	9. 40° 3'37.71"N 19°47'43.79"E	13. 40° 3'43.41"N 19°47'17.56"E
2. 40° 3'51.58"N 19°47'37.51"E	6. 40° 3'42.07"N 19°47'44.53"E	10. 40° 3'36.14"N 19°47'33.37"E	14. 40° 3'49.50"N 19°47'20.69"E
3. 40° 3'48.52"N 19°47'39.10"E	7. 40° 3'40.43"N 19°47'47.39"E	11. 40° 3'36.89"N 19°47'26.17"E	15. 40° 3'50.77"N 19°47'26.68"E
4. 40° 3'46.45"N 19°47'40.52"E	8. 40° 3'39.29"N 19°47'46.59"E	12. 40° 3'39.37"N 19°47'20.91"E	

(Shënim: Distanca më e afërt e këshitjellës nga perimetri i zonës mbrojtur është 160 m dhe më e largëta 484 m).

DOKUMENTACIONI FOTOGRAFIK





BIBLIOGRAFIA:

Pouqueville. F.H.C.L. , Voyage de la Grece,Volume 1. Paris, 1826, fq. 99.

Karaiskaj. GJ., Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri. ShB "8 Nëntori". 1981. f, 270-272.

Historia e Arkitekturës Shqiptare. A. Baçe, A. Meksi, E. Riza. Maket, Tiranë, 1979, f. 332.

Përgatiti :**Dt. Gusht 2014**

1. Kriledian Çipa
2. Vasil Dako
3. Amalia Goro

KARTELA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË PALUAJTSHME				
TË DHËNA ADMINISTRATIVE				
NR. I SKEDËS				
EMËRTIMI	Kalja e Prezes			
FUSHA	Arkeologji			
GJINIA	Vendbanim			
TIPOLOGJIA	Kala			
KODI I ARKIVIT	006			
ADRESA	Prezë			
VENDNDODHJA	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	FSHATI
	Tiranë		Prezë	Prezë
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)	KATEGORIA I			
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES	Nr vendimi 586 e 4874 me dt 17.03.1948 \ 23.09.1971			
INSTITUCIONI I SHPALLJES	Aprov... Ligj Nr. 609, dt.24.05.1948.			
DATIMI (VITI / SHEK)	Mesjete			
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK	DRKK - Durrës			
PËRDORIMI FILESTAR	Vendbanim \ Kala			
PËRDORIMI I TANISHËM	Atraksion Turistik			
A KA RRETHIM OBJEKTI? / GJENDJA E TIJ	Po \ Shume e mire			
ZONA E MBROJTUR	Po			
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT	41 25'53.2"N 19 40'20.6"E			
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR	Jan ne harten e zonifikimit			
PRONËSIA	Shtet			
EMRI I PRONARIT (-VE)	Nuk ka			
NR. I PRONËSISE	326 \ 5			
ZONA KADASTRALE	1299			
SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT	80 x 50 m \ Lartësin qe kanë kullat dhe Sahati 17m lartesi maksimale muret 6.4m, minimale 1m			
SIPERFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT	4000 m ²			
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR				
A KA RRUGË AUTOMOBILISTIKE DERI NË MONUMENT? / GJENDJA E SAJ	Po \ Shume e mire			

TË DHENA TEKNIKE				
PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK	<p>Ajo kishte për qëllim të mbante nën kontroll një zonë kryengritjesh të përhershme, siç ishte territori rreth Krujës, si dhe të ruante rrugën e rëndësishme që lidhte Shkodrën me Durrësin dhe Krujën.</p> <p>Kështjella është ndërtuar në një nga majat e një vargu kodrinor, që kufizon fushën e Tiranës në anën veriperëndimore. Ajo ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt me kulla të rrumbu-llakëta në katër nga qos'het e tij dhe me një kullë drejtkëndëshe pranë mesit të njërit prej mureve. Kjo kullë ka shërbyer edhe si porta e vetme e kështjellës, ndërsa një dalje e vogël katërkëndëshe, që luante rolin e një kulle, ndodhet në murin perëndimor. Për të kontro- lluar të vetmen qoshe të pesëkëndëshit, që nuk është pajisur me kullë, ka qenë ndërtuar një ballkon i vogël që mbështetej mbi një sistem kon- solash të lidhur me harqe tullash. Gjurmët e një ballkoni të tillë janë ruajtur edhe në murin perëndimor</p>			
PËRSHKRIMI KONSTRUKTIV	<p>Kalaja ka një gjatësi prej 80 m dhe gjerësi 50 m. Në oborrin e saj ndodhet një sterë e madhe, ndërsa mbi portë, në një fazë të dytë, është ndërtuar një xhami. Lar- tësia maksimale e ruajtur e mureve arrin në 6.40 m, ndërsa kullat në trajtë cilindrike me faqe vertikale ngrihen vetëm 0,50-0,60 m mbi lartë- sinë e tyre. Trashësia e mureve është 1,30-1,40 m, Në pjesën e sipër- me ato kanë qenë kurorëzuar me bedena. Nga disa gjurmë të ruajtura del se lartësia e tyre ishte 1,70 m, ndërsa muri mbi të cilin mbështete- shin 1 m. Për të çuar në shtegun e rojeve janë ndërtuar shkallë të gu- rta. Një shkallë e tillë ruhet në murin jugor, ajo është ndërtuar pjesërisht brenda trashësisë së murit.</p>			
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE NË VITE, SHKALLËT E NDERHYRJES <i>/ 1 / 2 / 3 / 4 / 5 /</i> <i>(nga nderhyrja me e lehtë tek me thellë)</i>	VITI	VITI	VITI	VITI
GJENDJA E KONSERVIMIT SHKALLËT E GJENDJES <i>/ 1 / 2 / 3 / 4 / 5 /</i> <i>(nga problematika me e lehtë tek me rëndë)</i>	ÇATIA / MBULESA	DYER / DRITARE	TAVANI/ NDERKATI	STRUKTURA E DRURIT NE AMBIENTET E BRENSHEM (MAFILI, KOLONA, etj)
	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
	AFRESKU	IKONOSTASI	MINARJA / KEMBANARJA	DYSHEMEJA/MOZAIK
	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
NDËRHYRJET KONSERVUESE / RESTAURUESE QË PROPOZOHEN	<p>1. Eshte hartuar projekti i restaurimit te kullës se Sahati pritet te shqyrtohet ne keshillin shkencor (IMK).</p>			

DOKUMENTACIONI GRAFIK DHE HARTOGRAFIK

ZONA MBROJTËSE E KALASË SË PREZËS, TIRANË



MIRATOHET :
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI
ZNJ. MIRELA KUMBARO FURXHI



APROVOHET :

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË
KULTURËS "G.STRAZIMIRI"



DREJTOR I PËRGJITHSHËM
ZNJ. ARTA DOLLANI





LEGJENDA: — Monumenti — Perimetri i zonës së mbrojtur
Koordinatat e sipërfaqes së zonifikimit:

1. 41°25'42.83"N	19°40'18.26"E	6. 41°26'0.60"N	19°40'22.68"E
2. 41°25'44.66"N	19°40'27.24"E	7. 41°26'0.16"N	19°40'16.67"E
3. 41°25'47.71"N	19°40'34.56"E	8. 41°25'58.72"N	19°40'8.50"E
4. 41°25'53.23"N	19°40'33.51"E	9. 41°25'54.38"N	19°40'10.57"E
5. 41°25'59.68"N	19°40'30.43"E	10. 41°25'50.58"N	19°40'17.03"E

Urdhëri nr 37 datë 02/02/2015





DOKUMENTACIONI FOTOGRAFIK





Foto 2015- 2016








Foto 2018

BIBLIOGRAFIA:


1. L. Papajani. Kalaja e Prezës. Monumentet 7-8, 1974, 167-181.
2. M. Barleti. Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut. Botimi i II, 1967, 249-250.
3. Relacion anonim mbi Shqipërinë. Burime të zgjedhura vëll. III, 1962, 164

KARTELA PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË PALUAJTSHME				
TË DHËNA ADMINISTRATIVE				
NR. I SKEDËS	36			
EMËRTIMI	KALAJA E HIMARËS			
FUSHA	ARKITEKTURË			
GJINIA	VENDBANIM I FORTIFIKUAR			
TIPOLOGJIA	KALA			
KODI I ARKIVIT	NR. 31974			
ADRESA	-			
VENDNDODHJA	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	FSHATI
	VLORË	HIMARË		HIMARË
STATUSI I MBROJTJES (KATEGORIA I, II)	KATEGOTIA I			
NR. I VENDIMIT , DATA E SHPALLJES	NR. 6, Dt, 15. 01. 1963.			
INSTITUCIONI I SHPALLJES	REKTORATI I UNIVERSITETIT SHTETËROR			
DATIMI (VITI / SHEK)	SHEK. VIII p.e.s			
INSTITUCIONI, ADMINISTRUES / DRKK	D.R.K.K. VLORË			
PËRDORIMI FILLESTAR	VEMDBANIM I FORTIFIKUAR			
PËRDORIMI I TANISHËM	VENDBANIM			
A KA RRETHIM OBJEKTI? / GJENDJA E TIJ	JO			
ZONA E MBROJTUR	-			
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE TE MONUMENTIT	N 40°07'02.45" E 19°43'57.10			
KOORDINATA GJEOGRAFIKE TË ZONËS SË MBROJTUR	-			
PRONËSIA	PRIVATE			
EMRI I PRONARIT (-VE)	-			
NR. I PRONËSISE	-			
ZONA KADASTRALE	NR. 2832			
SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT / LARTËSIA E OBJEKTIT	45137.77 m ² /250 m mbi niveline detit.			
SIPERFAQJA E PËRGJ. E RRETHIMIT	-			
SIPËRFAQJA E ZONËS SË MBROJTUR	-			
